

(2) Тимот презема соодветни технички и организационски мерки за безбедност на податоците во Базата, особено со цел за:

- 1) одбивање пристап на неовластени лица до опремата за обработка на податоците;
- 2) спречување на неовластена обработка на податоци;
- 3) управување со процесот на заштита на податоците;
- 4) прегледување и откривање на записите за сите извршени операции во системот за обработка на податоци;
- 5) обезбедување на резервни копии (backup) на податоците со цел за обновување на податоците (recovery) во случај на блокирање (испад) или неправилно функционирање на системот;
- 6) обезбедување на правилно функционирање на Базата во случај на промена на системите за обработка на податоци и
- 7) спроведување на безбедносната документација донесена од Комисијата.

V. НАДЗОР

Надзор

Член 17

(1) Министерството за труд и социјална политика врши надзор над спроведувањето на овој закон.

(2) Дирекцијата за заштита на личните податоци врши надзор над обработката на личните податоци и нивната заштита, согласно со закон.

VI. КАЗНЕНИ ОДРЕДБИ

Неовластена обработка на податоци

Член 18

Доколку лицата вработени во надлежните органи прибавиле имотна корист, предизвикале имотна штета или оштетиле друго лице, ќе се казнат со казна затвор од шест месеци до една година.

VII. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

Член 19

(1) Комисијата од членот 10 од овој закон ќе се формира во рок од 30 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

(2) Тимот од членот 11 на овој закон ќе се формира во рок од 30 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

(3) Базата ќе започне со работа во рок од 30 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 20

Подзаконските акти предвидени со овој закон ќе се донесат во рок од шест месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 21

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“, а ќе отпочне да се применува од 1 јули 2016 година.

L I G J PËR BAZËN NACIONALE TË TË DHËNAVE PËR PERSONA ME INVALIDITET

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda e rregullimit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen vendosja dhe funksionimi i bazës nacionale të të dhënave për persona me invaliditet, përpunimi i të dhënave në bazë, shfrytëzimi i të dhënave në bazë, siguria e të dhënave dhe mbikëqyrja mbi funksionimin e bazës.

Domethënia e shprehjeve

Neni 2

(1) Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë domethënien si vijon:

1. **“Të dhëna”** janë të dhëna personale, informata që kanë të bëjnë me invaliditetin e përcaktuar të personave në bazë të të cilit realizojnë të drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor, sigurimi shëndetësor, mbrojtja sociale, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtja luftëtare – invalidore, si dhe të dhëna për persona të punësuar dhe papunësuar me invaliditet.

2. E dhënë e pavërtetë është cila do qoftë e dhënë e paplotë, e parregullt, e pasaktë apo e pakorrigjuar.

3. **“Invaliditeti”** përfshin:

- paaftësi të përgjithshme, përkatësisht profesionale për punë, paaftësi për jetë dhe punë të pavarur, aftësi e zvogëluar pune, aftësi e humbur pune, dëmtim trupor sipas rregullave nga sigurimi pensional dhe invalidor;

- dëmtimi i shikimit, dëmtimi i dëgjimit, pengesë në zë, të folur dhe gjuhë, dëmtim trupor, pengesa në zhvillimin intelektual, pengesa të kombinuara në zhvillim, pengesa në zhvillimin mendor dhe fizik dhe pengesa të kombinuara deri në 26 vjet, sipas rregullave nga mbrojtja sociale, rregullave për punësim të personave invalidor dhe mbrojtja e fëmijëve;

- dëmtimi i organizmit sipas rregullave për pension për invalid civil, pension për invalid ushtarak dhe rregullave për pjesëtarë të forcave të sigurisë të Republikës së Maqedonisë.

4. **“Përpunimi i të dhënave”** është secili operacion apo përmbledhja e operacioneve që kryhen mbi të dhëna, në mënyrë automatike apo në mënyrë tjetër, siç është vendosja, memorimi, organizmi, ndryshimi, azhurnimi, kërkimi, analizimi, shfrytëzimi, rruajtja, zbulimi, dhënia për shfrytëzim, bartja, ndërmarrja, shkëmbimi, tërheqja, bllokimi, shlyerja dhe asgjësimi.

5. **“Administrimi i bazës”** është përmbledhje e masave dhe aktiviteteve për mbajtjen e integritetit të të dhënave në bazë; sigurimi i nivelit adekuat të mbrojtjes dhe arritshmërisë së të dhënave; mbajtja, mbikëqyrja dhe mbrojtja e sistemit për përpunimin e të dhënave; mbajtja, mbikëqyrja dhe mbrojtja e rrjetit për dhënien për shfrytëzim të të dhënave; dizajnimi dhe mbikëqyrja e performancave të bazës dhe zbatimin e standardeve për përdorim dhe siguri të bazës dhe

6. **“Organe kompetente”** janë organe të cilat në pajtim me ligj janë kompetente të përpunojnë dhe japin për shfrytëzim të dhëna.

(2) Shprehjet që përdoren në këtë ligj, rëndësia e të cilave nuk është definuar në paragrafin (1) të këtij neni, kanë rëndësi të përcaktuar me ligj tjetër.

II. THEMELIMI DHE FUNKSIONIMI I BAZËS NACIONALE TË TË DHËNAVE PËR INVALIDITET

Themelimi

Neni 3

Në Drejtorinë për Shëndetësi Elektronike themelohet Baza Nacionale e të Dhënave për persona me invaliditet (në tekstin e mëtuftjeshëm: Baza), në kuadër të sistemit informativ shëndetësor të integruar

Funksioni i Bazës

Neni 4

Baza paraqet një pjesë nga sistemi informativ shëndetësor i integruar i cili mundëson përpunimin dhe dhënien për shfrytëzim të të dhënave ndërmjet organeve kompetente, me qëllim vendosjen e evidencës së vetme të të dhënave dhe realizimit të të drejtave në bazë të invaliditetit në pajtim me ligjin.

Përmbajtja e Bazës

Neni 5

(1) Baza përmban të dhëna për persona të cilët është përcaktuar invaliditet në bazë të të cilit kanë realizuar apo mund të realizojnë të drejtë në pajtim me ligj edhe atë nga:

1. sigurimi pensional dhe invalidor,
2. sigurimi shëndetësor,
3. mbrojtja sociale,
4. mbrojtja e fëmijëve,
5. punësimi i personave invalidë dhe
6. mbrojtja luftëtare – invalidore dhe pension për invalidë civilë.

(2) Në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, Baza i përmban këto të dhëna personale:

1. numrin unik amë të qytetarit;
2. diagnozat për invaliditetin sipas Klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve KNS-10;
3. llojin e të drejtës së realizuar në bazë të invaliditetit të përcaktuar;

4. datën e fitimit dhe ndërprerjes së të drejtës dhe

5. datën për kontroll të invaliditetit.

(3) Në pajtim me paragrafin (1) pika 1 të këtij neni, Baza i përmban edhe këto të dhëna:

1. të drejtën e realizuar për pension invalidor të përkohshëm apo përhershëm;
2. të drejtë për ndryshimin e vendit të punës;
3. të drejtën për kohë pune të shkurtuar;
4. të drejtën për rikualifikim apo kualifikim plotësues dhe
5. të drejtën për kompensim me para për dëmtim trupor.

(4) Në pajtim me paragrafin (1) pikën 2 të këtij neni, Baza i përmban edhe këto të dhëna:

1. të drejtën për pengesë të përkohshme për punë për shkak të përkujdesjes së anëtarit të familjes, përkujdesjes së fëmijës deri në moshën tre vjeçare, përkujdesjes së anëtarit të sëmurë të familjes më të ngushtë mbi moshën tre vjeçare, por më shumti deri në 30 ditë;

2. të drejtën për pengesë të përkohshme nga puna për shkak të mjekimit apo kontrollit mjekësor;

3. të drejtën për pengesë të përkohshme nga puna për shkak të lëndimit në punë dhe

4. të drejtën për mjete ndihmëse ortopedike dhe mjete tjera, pajisje ndihmëse dhe sanitare sipas llojeve.

(5) Në pajtim me paragrafin (1) pikën 3 të këtij neni, Baza i përmban edhe të dhënat për të drejtat nga mbrojtja sociale edhe atë:

1. të drejtën për kompensim me para për ndihmë dhe përkujdesje nga personi tjetër;

2. të drejtën për shtesa për verbëri dhe mobilitet;

3. të drejtën për shtesa për shurdhësi;

4. të drejtën për kompensim të rrogës për kohë të shkurtuar pune për shkak të përkujdesjes së fëmijës me pengesa trupore apo mentale në zhvillim;

5. të drejtën për ndihmë të përhershme me para për person të paaftë për punë dhe

6. të drejtën për ndihmë me para nga mbrojtja sociale në pajtim me rregullat për mbrojtje sociale.

(6) Në pajtim me paragrafin (1) pikën 4 të këtij neni, Baza i përmban edhe këto të dhëna:

1. të drejtën për shtesë të veçantë dhe

2. të drejtat në pajtim me rregullat për mbrojtje të fëmijëve

(7) Në pajtim me paragrafin (1) pikën 5 të këtij neni, Baza i përmban edhe këto të dhëna:

1. të drejtën për punësim të personit invalidor në shoqëri tregtare mbrojtëse apo tregun e hapur të punës dhe

2. shkallën e arsimimit.

(8) Në pajtim me paragrafin (1) pikën 6 të këtij neni, Baza i përmban edhe këto të dhëna:

1. të drejtën për pension invalidor civil;

2. të drejtën për pension invalidor ushtarak dhe

3. kompensim me para për ndihmë dhe përkujdesje të personit tjetër.

(9) Baza përmban të dhëna edhe për fëmijët e lindur me rrezik të cilët i zbulon dhe paraqet institucioni shëndetësor (maternitet, këshillim zhvillimor, dispanzer për fëmijë dhe institucione tjera nga mbrojtja primare), për persona me invaliditet të përcaktuar në periudhën e fëmijërisë së hershme, të dhëna për personat e sëmurë nga sëmundje të rralla dhe kronike, si dhe të dhëna për nxënës me nevoja të veçanta arsimore të cilët shkollohen në shkollat filllore dhe të mesme komunale dhe shtetërore.

Organe kompetente për përpunimin e të dhënave nga Baza

Neni 6

Përpunim të të dhënave nga Baza kryejnë këto organe kompetente:

1. Drejtoria për Shëndetësi Elektronike;
2. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale;
3. Fondi për Sigurim Shëndetësor i Maqedonisë;
4. Fondi për Sigurimin Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë;
5. Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë dhe
6. Institucionet Shëndetësore Publike.

Organe kompetente për dhënien e shfrytëzimit të të dhënave

Neni 7

Dhënie për shfrytëzim të të dhënave nëpërmjet Bazës kryejnë këto organe kompetente:

1. Drejtoria për Shëndetësi Elektronike;
2. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale;
3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
4. Fondi për Sigurim Shëndetësor i Maqedonisë;
5. Fondi për Sigurimin Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë;
6. Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë;

7. Qendrat për punë sociale;
8. Instituti për shëndet publik dhe institucionet shëndetësore nga neni 5 paragrafi (9) të këtij ligji.

Përpunimi i të dhënave personale

Neni 8

(1) Të dhënat personale që vendosen në Bazë mund të përpunohen në pajtim me qëllimet e përcaktuara me këtë ligj dhe në pajtim me rregullat për mbrojtje të të dhënave personale.

(2) Të dhënat personale të cilat janë përfshirë në proceset e përpunimit dhe dhënien për shfrytëzim të të dhënave shlyhen në rastet kur do të përcaktohet se nuk janë të sakta apo kanë pushuar arsyet, përkatësisht kushtet për shkak të të cilave e dhëna personale është përfshirë në ato procese.

(3) Të dhënat personale të përmbajtura në Bazë nga vendosja e tyre, deri në shlyerjen e tyre guxon të jepen me kushte dhe në mënyrë të përcaktuara me këtë ligj dhe me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Komisioni për Menaxhim me Bazën

Neni 9

(1) Për shkak të sigurimit të përpunimit të të dhënave dhe plotësimit të standardeve për sigurinë e Bazës në pajtim me ligj, si dhe për arritjen e koordinimit efikas ndërmjet organeve kompetente formohet Komisioni për Menaxhim me Bazën (në tekstin e mëtuftjeshëm: Komisioni).

(2) Anëtarët e Komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë për periudhën prej katër viteve.

(3) Komisioni është i përbërë prej nëntë anëtarësh edhe atë: dy anëtarë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, dy anëtarë nga Drejtoria për Shëndetësi Elektronike dhe nga një anëtar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Fondi për Sigurim Shëndetësor i Maqedonisë, Fondi për Sigurimin Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë, Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë dhe Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

(4) Kryetari i Komisionit zgjidhet nga radha e anëtarëve të Komisionit nga paragrafi (2) i këtij neni për periudhë prej dy vitesh.

Punë të cilat i kryen Komisioni

Neni 10

(1) Komisioni i kryen këto punë:

1) jep propozime për ndarjen dhe marrjen e qasjes, si dhe nivelin e qasjes së Bazës të personave të punësuar në organe kompetente;

2) kryen administrimin e sigurisë së Bazës e cila ka të bëjë me menaxhimin e mjeteve, sigurisë fizike dhe funksioneve të sigurisë për resurse njerëzore;

3) sjell procedura dhe standarde për sigurimin e sekretit dhe mbrojtjen e të dhënave të përmbajtura në Bazë dhe kryen kontrollin për zbatimin e tyre;

4) dorëzon informata në organet kompetente për funksionim të sigurt të Bazës;

5) i koordinon aktivitetet e organeve kompetente lidhur me bashkëpunimin e të dhënave nga Baza;

6) kujdeset për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe shpresave nënligjore të parapara me këtë ligj dhe

7) kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Komisioni për punën e vet miraton rregullore.

(3) Punët administrative teknike të Komisionit i kryen Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(4) Komisioni një herë në vit dorëzon raport për punën e vet në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për informim.

Administrimi i bazës

Neni 11

(1) Në Drejtorinë për Shëndetësi Elektronike formohet Ekipi për administrim të bazës (në tekstin e mëtejshëm: Ekipi).

(2) Ekipi është i përbërë nga persona të punësuar në Drejtorinë për Shëndetësi Elektronike dhe atë koordinatorë, zëvendës-koordinator dhe anëtarë.

(3) Organet kompetente janë të obliguar të përcaktojnë person të autorizuar për administrim me bazat e të dhënave që organet kompetente i menaxhojnë në pajtim me ligjin me qëllim të funksionimit më efikas të bazës.

III. PËRPUNIM I TË DHËNAVE NË BAZË

Qasja në bazë

Neni 12

(1) Personave të punësuar në organet kompetente mund t'u ndahet qasje në bazë nëse punojnë në vendet e punës për të cilat është përcaktuar nevoja konkrete për shfrytëzimin e të dhënave nga baza sipas aktit për sistematizimin e vendeve të punës të atij organi.

(2) Personave nga paragrafi (1) i këtij neni u hiqet qasja, nëse:

1. nuk punojmë më në vendet e punës për të cilat është përcaktuar nevoja konkrete për shfrytëzimin e të dhënave nga baza.

2. pa autorizim i shfrytëzojnë të dhënat nga baza dhe

3. nuk i zbatojnë standardet për sigurinë e bazës.

(3) Mënyrën e ndarjes së qasjes, nivelet e qasjes, kohëzgjatjen e qasjes dhe mënyra e procedurës për përcaktimin e ndërprerjes për marrjen e qasjes, i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Shëndetësisë.

Përgjegjësia për përpunimin e të dhënave

Neni 13

(1) Organet kompetente nga neni 7 i këtij ligji janë përgjegjëse për përpunimin e të dhënave të Bazës dhe për vërtetësinë dhe autenticitetin e tyre.

(2) Personat e punësuar në organet kompetente janë të obliguar, në afat sa më të shkurtër t'i plotësojnë të dhënat në Bazë.

(3) Nëse organi kompetent përcakton të pavërteta për të dhëna të caktuara që janë futur në Bazë nga ana e tij, menjëherë për këtë e informon Ekipin dhe merr qasje për shlyerjen e të dhënave.

(4) Vetëm organi kompetent që i ka vendosë të dhënat mund t'i ndryshojë, shlyejë dhe asgjësojë të dhënat jo të vërteta.

(5) Në rast kur organet kompetente në Bazë kanë vendosur të dhëna të ndryshme për person të njëjtë, do të konsultohen në mënyrë të ndërsjellë që të përcaktohen se cilat të dhëna janë të pavërteta.

(6) Nëse organet kompetente përmes konsultimeve të ndërsjella nuk mund të konstatojnë se cilat të dhëna janë të pavërteta, për këtë vendos komisioni.

(7) Organet kompetente detyrimisht bashkëpunojnë me ekipin kur përcaktohet ekzistimi i nevojës së ndryshimit, përkatësisht të shlyerjes dhe asgjësimit të dhënave nga Baza.

Mënyra e përpunimit dhe afatet e ruajtjes

Neni 14

(1) Të dhënat ruhen përjetësisht edhe në formë elektronike në Bazë.

(2) Mënyrën e përpunimit dhe ruajtjen e të dhënave në Bazë, i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Shëndetësisë.

Obligimi për ruajtjen e sekretit për të dhënat

Neni 15

Personat e punësuar në organet kompetente të cilëve iu është ndarë qasje në bazë janë të obliguar ta ruajnë sekretin e të dhënave deri te të cilat kanë arritur në punën e vet, sikur gjatë kohës së marrëdhënies së tyre të punës në organet kompetente, ashtu edhe pas përfundimit të tyre, të cilat paraqesin të dhëna personale në pajtim me ligjin.

IV. SIGURIA E TË DHËNAVE NË BAZË

Siguria e të dhënave në Bazë

Neni 16

(1) Organet kompetente janë të obliguar në pajtim me ligjin t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme teknike dhe organizuese që të sigurojnë mbrojtje, përkatësisht siguri për të dhënat të cilat i përpunojnë në bazë, si dhe masat nga paragrafi (2) pika 1), 2), 6) dhe 7) e këtij ligji.

(2) Ekipi ndërmerr masa përkatëse teknike dhe organizuese për sigurinë e të dhënave në bazë, në veçanti për këtë qëllim për:

1) refuzimin e qasjes së personave të paautorizuar në pajisjet për përpunimin e të dhënave;

2) pengimin e përpunimit të paautorizuar për të dhënat;

3) menaxhimin me proceset për mbrojtjen e të dhënave;

4) shqyrtimin dhe zbulimin e shkresave për të gjitha operacionet e kryera në sistemin për përpunimin e të dhënave;

5) sigurimin e kapjeve rezerve (backup) për të dhënat me qëllim të ripërtëritjes së të dhënave (recovery) në rast të bllokimit (rënies) ose funksionimit jo të rregullt të sistemit;

6) sigurimin e funksionimit jo të rregullt të bazës në rast të ndryshimit të sistemit për përpunimin e të dhënave dhe

7) zbatimin e dokumentacionit të sigurisë të miratuar nga komisioni.

V. MBIKËQYRJA

Mbikëqyrja

Neni 17

(1) Ministria e Punës dhe Politikës Sociale kryen mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji.

(2) Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kryen mbikëqyrjen mbi përpunimin e të dhënave dhe mbrojtjen e tyre, në pajtim me ligjin.

VI. DISPOZITA NDËSHKUESE

Përpunimi i paautorizuar i të dhënave

Neni 18

Nëse personat e punësuar në organet kompetente kanë përfituar dobi pronësore, kanë shkaktuar dëm pronësor ose kanë dëmtuar person tjetër, do të dënohen me dënim me burg prej gjashtë muaj deri në një vit.

VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 19

(1) Komisioni nga neni 10 i këtij ligji do të formohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Ekipi nga neni 11 i këtij ligji do të formohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Baza do të fillojë me punë në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 20

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 korriku 2016.

4050.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

**ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПРЕСТА-
НУВАЊЕ НА ВАЖЕЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ОПРЕДЕ-
ЛУВАЊЕ НА УСЛОВ ЗА ОГРАНИЧУВАЊЕ ЗА
ВРШЕЊЕ НА ЈАВНА ФУНКЦИЈА, ПРИСТАП НА
ДОКУМЕНТИ И ОБЈАВУВАЊЕ НА СОРАБОТКА-
ТА СО ОРГАНИТЕ НА ДРЖАВНАТА БЕЗБЕДНОСТ**

Се прогласува Законот за престанување на важење на Законот за определување на услов за ограничување за вршење на јавна функција, пристап на документи и објавување на соработката со органите на државната безбедност,

што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 21 август 2015 година.

Бр. 08-3635/1

21 август 2015 година
Скопје

Претседател

на Република Македонија,
д-р **Горге Иванов**, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.

ЗАКОН

**ЗА ПРЕСТАНУВАЊЕ НА ВАЖЕЊЕ НА ЗАКО-
НОТ ЗА ОПРЕДЕЛУВАЊЕ НА УСЛОВ ЗА ОГРА-
НИЧУВАЊЕ ЗА ВРШЕЊЕ НА ЈАВНА ФУН-
КЦИЈА, ПРИСТАП НА ДОКУМЕНТИ И ОБЈАВУ-
ВАЊЕ НА СОРАБОТКАТА СО ОРГАНИТЕ НА
ДРЖАВНАТА БЕЗБЕДНОСТ**

Член 1

Со овој закон престанува да важи Законот за определување на услов за ограничување за вршење на јавна функција, пристап на документи и објавување на соработката со органите на државната безбедност („Службен весник на Република Македонија“ број 86/12).